



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.121/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha, kryetar, Delushe Halimi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glogocit, nga radhët e Subjekti Politik për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), i përfaqësuar sipas autorizimit nga “SHALA LAW OFFICE” L.L.C. me avokat Halim Shala në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ), me seli në Prishtinë, me numër 01/3243-2025 dt.5.11.2025, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për anëtarë të Kuvendit Komunal, të mbajtura më dt.12 Tetor 2025, duke vendosur sipas ankesës së Labinot Halilaj, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZL.Anr.440/2025 të datës 14.11.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.11.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga Labinot Halilaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Glogocit, nga Subjekti Politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin, (PDKRLL), paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.440/2025 të datës 14.11.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (PZAP) ZL. Anr.440/2025 të datës 14.11.2025, është vendosur të HEDHET e pas afatshme ankesa e parashtruar nga Labinot



Halilaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Për Drenasin Kampion me Ramiz LLadrovcin, (PDKRLL), ZL.Anr.440/2025 dt.13.11.2025, të paraqitur kundër vendimit Nr.01/3243-2025 dt.5.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Glllogoc dhe parregullsive gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të datës 12 tetor 2025.

Kandidati i sipër përmendur për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me numër si më lartë, dt. 14.11.2025, në Gjykatën Supreme ka paraqitur ankesë, (dt.18.11.2025), me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të përmendur, duke propozuar që ankesa të pranohet, dhe siç thuhet në të, Gjykata Supreme të shfuqizojë vendimin e lartë cekur të PZAP-së, të urdhërojë PZAP-në, që të dërgojë në rinumërim të tërësishëm të gjitha vendvotimet për Kandidat për Kuvendin Komunal në Glllogoc, të urdhërojë PZAP-in që të hetojë të gjitha shkeljet, ankimua, raportuara dhe të faktuara me prova, nga secili individ dhe organ i angazhuar ditën e zgjedhjeve e të cilat konsumojnë elemente inkriminuese penale ku cenohen zgjedhjet e lira dhe procesi i transparencës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në përgjigje të ankesës, qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimin e vet, dhe propozoi që ankesa të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të vendimit të atakuar pretendimeve ankimore dhe atyre në përgjigje në ankesë, shqyrtoi shkresat e tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Labinot Halilaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit nga Subjekti Politik Për Drenasin Kampion me Ramiz LLadrovcin, kundër vendimit me numër 01/3243-2025 i datës 5.11.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2025, për Kuvendin Komunal, ka paraqitur ankesë ZL.Anr.440/2025 më datë 13.11.2025, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me pretendimet e sipër përmendura, dhe si në ankesën e tij të dt.18.11.2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me vendimin ZL.Anr.440/2025 të datës 14.11.2025, ka vendosur të hedhet si e pas afatshme ankesa Anr.440/2025, dt.13.11.2025, e paraqitur nga kandidati i sipër përmendur për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, duke vendosur më specifikisht si në dispozitiv të vendimit të përshkruar më lart.



Në përgjigjen në ankesë të KQZ-së, theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloren Zgjedhore nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 1.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në QKN në përputhje me par.3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore nr.13/2024 Rezultatet zgjedhore me nenin 9 par.1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Në përputhje me nenin e lartë cekur, KQZ më dt.24.10.2025, ka marrë vendimin me nr. të pr.01/3006/2025 për Miratimin e Rekomandimit pas procesit të Rinumërimit në QNR, ku ndër vendvotimet e rinumëruara kanë qenë edhe vendvotimet nr.0305/02, 0327/01, 0329/02 në Komunën e Glllogocit. Pas rinumërimit kanë rezultuar se në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar, në vendvotimin 0327/01 është rritur të tolerancës +-1, në mënyrë që vendvotimi të procedohet si i rregullt, ndërsa, në vendvotimin 0329/02 pas rinumërimit të kutisë tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim me pas sesa numri i shënuar në QKN dhe kështu më nuk ekziston diferenca. PZAP-i me vendimin ZL.Anr.416/2025 dt.10.11.2025, ka marrë vendimin për rinumërimin e vendvotimeve që pala i ka cekur në ankesë, me numrat nga 0307/01 deri tek 0315/02, si në ankesën e tij. Pra, vendvotimet e lartë cekura tashmë janë rinumëruar me vendim të PZAP-it, andaj, ankesa e palës lidhur me hetimin dhe rinumërimin e këtyre vendvotimeve nuk qëndron, sepse me rinumërimin e tyre tashmë çështja është përfunduar dhe rezultatet e rinumërimit janë përfshirë në rezultatet përfundimtare. Gjithashtu, lidhur me pretendimin që pala e ka ngritur lidhur me administrimin e punës në QKN, sipas nenit 105 të LZP-së, ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it, brenda 48 orëve nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar, andaj, KQZ-ja, ju njofton se procesi i numërimit dhe administrimit të punës në QKN në Komunën e Glllogocit ka përfunduar më dt.18.10.2025. KQZ pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta në QKN, fletëvotimeve nga votimi me kusht, fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta dhe fletëvotimeve nga votimi me kusht dhe votimi jashtë Kosovës, në QNR, ka shpallur rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal, të mbajtura më dt. 12 tetor 2025, për Komunën e Glllogocit, me vendim nr.0-



1/3243/2025 dt.5.11.2025. Në pikën 3 të vendimit, i ka udhëzuar palët që për ankesat eventuale në lidhje me shpalljen e rezultateve përfundimtare, mund të parashtrojnë ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve duke filluar nga data 5.11.2025 ora 15. Ndërsa, pala e ka dorëzuar ankesën më dt.13.11.2025 në ora 13,44, pra, jo brenda afatit ligjor si në pikën 3 të vendimit të KQZ-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës, shkresave të lëndës, ka gjetur se, pala ankuese, ankesën e ka parashtuar më datën 13.11.2025 kundër vendimit Nr.01/3243-2025 dt.5.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Gllogoc, ku KQZ rezultatet përfundimtare, i ka shpallur më dt.5.11.2025 në ora 15:00 h. Paneli vlerëson se pala ankuese, ankesën e ka dorëzuar me post private Mik Mik, në zarfin (plikon) e dorëzuar nuk është shënuar data e dorëzimit të ankesës në postë dhe se pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi – prova mbi datën e dorëzimit të ankesës në postë, ndërsa, ankesa është dorëzuar në PZAP më dt.13.11.2025 në ora 13:44 minuta, andaj, PZAP si datë të dorëzimit të ankesës e ka marr datën 13.11.2025, pra, kur ankesa është dorëzuar në PZAP. Prandaj, PZAP-i ka vlerësuar se ankesa e parashtuar nga Labinot Halilaj Kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gllogocit, nga Subjekti i sipër përmendur politik, ndaj publikimit të rezultateve përfundimtare, është parashtuar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat përkatëse ligjore, të cituara në arsyetimin e vendimit përkatës, andaj, vendosi që ankesa e ankuesit të hedhet si e pas afatshme, sepse rezultatet përfundimtare nga KQZ janë shpallur më dt.5.11.2025 në ora 15:00 h, afati për paraqitjen e ankesës ka qenë 48 orë nga shpallja e rezultateve përfundimtare, ndërsa, ankesa është paraqitur më dt.13.11.2025 në ora 13:44 minuta, që do të thotë pas afatit të paraparë ligjor.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, sipas të cilit ankesa e paraqitur nga këtu ankuesi, është e pas afatshme dhe vendosja si në dispozitiv të vendimit, kur është hedh ankesa e parashtresit, me pretendimet e sipër përmendura, është i drejtë dhe i ligjshëm, nga se pas afatshmëria e saj, është vërtetuar saktë nga PZAP-ja, me të dhënat e faktuara dhe të specifikuara si më lartë.

Nga sa u theksua më lartë, rezulton katërçipërisht se vërtetë ankesa e paraqitur nga Labinot Halilaj, kundër vendimit të sipër përmendur, është e pas afatshme. Kështu, me dispozitën e nenit 105. 1 të LZP, përcaktohet shprehimisht se “ Ankesat lidhur me administrimin e numërimit



në QKN dhe QNR , dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”. Po ashtu, me nenin 13 par.3, nënp.3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it i cili përcakton se “PZAP-i e hedh ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP -së dhe kësaj rregulloreje për shqyrtim: 3.2 nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”. Me dispozitën e nenit 9 par.5 të Rregullores së sipër përmendur, përcaktohet se “ Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda 48 orëve për shkeljet e pretenduara” etj.

Prandaj, nga këtu, kjo gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridik, është marrë vendim i drejtë, me të cilin nuk është bërë diskriminim dhe lidhur me rastin konkret nuk është cenuar e drejta zgjedhore dhe ndonjë e drejtë themelore e paraparë me Ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk janë cenuar parimet themelore të procesit zgjedhor të parapara shprehimisht me nenin 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me dispozitat përkatëse të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Për arsyet e paraqitura më lart, e në pajtim me nenin 118 pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.121/2025, datë 20.11.2025

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Omašćeni radnik
[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-121/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRISTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më 21.11.2025 201 _____ në ora 10:30
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GYKIM 20.11.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

[Signature]

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioča ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e tij. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.